



Anketë për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Shkodrës

SHTATOR 2022

Autorë: [Deanna Davy](#), Konsulente Ndërkombëtare për UNICEF në Shqipëri
[Blerina Metanaj](#), IDRA Shqipëri

Menaxhere Studimi: [Elda Denaj](#), Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit në UNICEF Shqipëri

Redaktor: [Iain Wilson](#)

Ky dokument u përgatit në kuadrin e Programit “*Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria*”, zbatuar nga një koalicion prej gjashtë organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare: UNICEF në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Terre des Homme, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Programi u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (MB).

Pikëpamjet e shprehura në raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të UNICEF-it apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materialin e këtij raporti në botimet e tyre, me kushtin që të citojnë burimin.

Citimi i rekomanduar për Raportin:

Davy, D., dhe Metanaj, B. (2022) “*Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë. Përmbledhje e gjetjeve: Vala e dytë: Raporti për qarkun e Shkodrës*” UNICEF Shqipëri dhe IDRA.

Për komente, korrigjime dhe sugjerime, ju lutemi kontaktoni në adresën: tirana@unicef.org

Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Shkodrës

Shtator 2022



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE.....	4
2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	5
3. METODOLOGJIA.....	6
4. GJETJE.....	7
5. PËRFUNDIME.....	22

1. HYRJE

Shqipëria është prekur ndjeshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe vazhdon të zhvillojë një sërë politikash dhe mekanizmash për të luftuar fenomenin. Vendi njihet si vendburim për trafikimin e qenieve njerëzore. Përmes rrjeteve të organizuara kriminale, shqiptarët trafikohen shpesh drejt Italisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Gjermanisë dhe Zvicrës. Megjithatë, trafikimi brenda vendit ka qenë një fenomen i konsiderueshëm për rreth dy dekada, ku shumica e viktimave vendase janë fëmijë dhe të rinj. Shumë viktimë shqiptare vijnë nga familje të varfra, janë të papunë dhe të paarsimuar. Për fëmijët dhe të rinjtë e trafikuar, faktorët e riskut e kanë zanafillën kryesisht nga situata familjare, dhe përfshijnë ndarjen ose braktisjen e familjes. Pasojë e këtyre faktorëve është fakti që atyre iu mungojnë rrjetet e rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes.

Pavarësisht të dhënave të qarta se të rinjtë shqiptarë janë të cenueshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore, ka mungesë literature në nivelin e njohurive të tyre për fenomenin brenda vendit, ose në qëndrimet dhe praktikën e tyre lidhur me të. Vetëm një studim i fundit (2016) trajton njohuritë dhe ndërgjegjësimin rreth trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri.¹ Nga ky studim, ne kuptojmë se: të rriturit shqiptarë kanë më shumë dijeni rreth trafikimit për qëllime seksuale sesa rreth trafikimit për qëllime pune; mbi gjysma e të rriturve shqiptarë të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz, i cili lidhet kryesisht me gratë dhe fëmijët; dhe se shumë persona nuk dinë se si mund t'i ndihmojnë viktimat e dyshuara.

Duke qenë se ai studim nuk trajtoi posaçërisht nivelin e njohurive të të rinjve, ose qëndrimet dhe praktikën e tyre lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, studimi aktual e shqyrton këtë çështje me qëllim plotësimin e mangësive të rëndësishme në njohuri. Rezultatet e studimit do të jenë të dobishme për qeverinë dhe palët e interesit joqeveritare që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Studimi aktual është një anketë e valës së dytë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të vendit, dhe ndërmjet romëve. Kjo anketë pason atë të valës së parë, rezultatet e së cilës u publikuan në dhjetor 2020.² Kjo anketë e valës së dytë përsërit pyetjet e valës së parë në masën maksimale të mundshme.

Ky raport përqendrohet vetëm te qarku i Shkodrës në Shqipëri, për të krahasuar rezultatet e anketës me ato të tri qarqeve të tjera: Dibër, Kukës dhe Tiranë. Një raport i përgjithshëm që paraqet gjetjet e anketës është publikuar, së bashku me katër raportet rajonale dhe një raport për të rinjtë romë. Për analizë të mëtejshme, të dhënat e mbledhura nga anketa e valës së dytë mbahen dhe vizualizohen në një panel të posaçëm.³

Paraqitja e rezultateve në nivel qarku është hartuar për të udhëhequr zhvillimin e përpjekjeve të komunikimit për trafikimin e qenieve njerëzore të përshtatura sipas kontekstit. Krahasimi këtu nuk bëhet ndërmjet rezultateve të anketës së valës së parë dhe të valës së dytë pasi ndryshimet në njohuri, qëndrime dhe praktika janë minimale. Duhet theksuar se aty ku nuk trajtohen të dhënat në tabela dhe shifrat ka të bëjë me faktin se ndryshimet janë të papërfillshme.

¹ USAID, 2016, Matja e opinionit publik lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Moldavi dhe Shqipëri duke përdorur anketa eksperimentuese për të informuar programet efektive të parandalimit dhe ndërgjegjësimin.

² Davy, D., dhe Metanj, B., 2020, [Anketë e valës së parë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë. Raport mbi gjetjet](#). Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, IDRA, UNICEF në Shqipëri:

³ [Paneli i studimit](#)

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Nëpërmjet këtij studimi synohet të kuptohet dhe eksplorohet niveli i ⁴njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në qarqet Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë, si dhe ndërmjet të rinjve romë.

Objektivat e studimit ishin krahasimi i diferencave në nivelet e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve të anketuar në katër qarqe:

Njohuritë

- Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore
- Format e shfrytëzimit që ndodh në Shqipëri dhe në vende të huaja
- Kush është i rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore
- Metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore
- Mënyrat për të mbështetur rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore
- Shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat

Qëndrimet

- Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore
- Qëndrimet nga viktimave

Praktikat

- Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore
- Interesi për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore

2.1 Rezultatet e komunikimeve të UNICEF-it

- Ekspozimi ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve
- Rritja e njohurive, qëndrimeve dhe interesit për t'u angazhuar në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rrjedhojë e ekspozimit

2.2 Struktura e raportit

Pas këtij seksioni hyrës, raporti paraqet metodologjinë e studimi, e pasuar nga gjetjet mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Raporti mbyllet me një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore.

⁴ Grupmosha 15–29 vjeç, siç përcaktohet nga Komisioni Evropian. Shihni EUROSTAT, Të rinjtë - Vështrim i përgjithshëm, <https://ec.europa.eu/eurostat/web/youth>.

3. METODOLOGJIA

3.1 Qasja ndaj anketës

Studimi aktual ka anketuar rreth 1,600 të rinj (Tabela 1), duke përfshirë të anketuar të grupmoshës 15-29 vjeç që jetojnë në Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë (350 të anketuar në secilin qark). Kampioni përfshiu një kampion plotësues prej 200 të rinjsh të popullatës rome që jetojnë në Kukës, Shkodër dhe Tiranë. Të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë rastësore. Të dhënat zyrtare⁵ tregojnë se janë në total rreth 300,000 persona të moshës 15-29 vjeç që jetojnë në qarqet ku u krye studimi. Si rrjedhojë, përmasa e kampionit të rreth 1,600 plotësuesve të anketës garanton rezultate përfaqësuese në nivel kombëtar me marzh gabimi prej 2.62% dhe me interval besueshmërie prej 95%. Marzhi i gabimit në nivel qarku është 5.24% me interval besueshmërie prej 95% (shihni Aneksin për një vështrim të përgjithshëm të metodologjisë). Anketa u zhvillua nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë. Vetëm një person për familje, i grupmoshës 15-29 vjeç, u ftua të merrte pjesë. Përzgjedhja rastësore e familjeve u bë nëpërmjet një softueri. Mbledhja e të dhënave u krye gjatë periudhës 14 janar deri në 1 mars 2022 nga intervistues të trajnuar të IDRA Research & Consulting. Çdo intervistë zgjati rreth 20 minuta.

Tabela 1. Numri i intervistave të anketës të kryera në secilin qark të synuar dhe me romët

Qarku	Nr.
Tiranë	350
Shkodër	350
Kukës	341
Dibër	346
Totali, 4 qarqe	1,387
Rom/e	200
Totali i të anketuarve (Nr.)	1,587

3.2 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u krye nga IDRA duke përdorur paketën softuerike të të dhënave statistikore IBM SPSS 25. Të dhënat u ponderuan për të qenë përfaqësuese për secilin qark dhe në tërësi. Kjo u bë në mënyrë që kontributi i plotësuesve të anketës nga secili qark të ishte përpjesëtimor me shifrat e popullsisë së qarkut. Rezultatet u ndanë sipas treguesve demografikë kryesorë, si gjinia dhe mosha.

3.3 Konsideratat etike

Anketa për trafikimin e qenieve njerëzore nuk përmbante pyetje të vështira ose të ndjeshme për të rinjtë. Megjithatë, u krye një vlerësim i etikës, pasi të dhënat u mbledhën nga fëmijë të grupmoshës 15-17 vjeç dhe më të rritur (18-29 vjeç). Përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave, studimi mori miratimin etik nga Health Media Lab. Ltd. Bordi i Kërkimit Etik.⁶ Për këtë studim, ekipi respektoi sa më poshtë:

- Rregulloren “Për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese”, dhe, në veçanti, nenin 1.1.4, që u kërkon institucioneve “të ruajnë një klimë bashkëpunimi që nxit përgjegjshmëri dhe etikë në kërkim”. Ky udhëzim (rregullore) u nxor nga Qeveria e Shqipërisë për të orientuar çështjet e lidhura me etikën për shoqëritë, institucionet dhe konsulentët që kryejnë punë kërkimore.
- Procedura e UNICEF-it për Standardet Etike në Kërkim, Vlerësim, Mbledhjen dhe Analizën e të Dhënave (2021)

Ekipi i kërkimit respektoi standardet e mëposhtme themelore:

- se subjektet nuk vihen në rrezik të tepruar;
- se pjesëmarrja është vullnetare, dhe subjektet informohen dhe u sigurohet një formular pëlqimi me të cilin duhet të bien dakord paraprakisht; dhe
- se ekzistojnë protokolle me shkrim për të siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, intervistuesit ndanë fletëpalosje me pjesëmarrësit në anketë dhe familjet e tyre, duke përfshirë informacion për shërbimet mbështetëse për kujdesin mendor dhe psikologjik, dhe kanalet e raportimit për trafikimin e qenieve njerëzore.

⁵ Instituti i Statistikave i Shqipërisë: [Rezultatet e Censurit të 2011](#); aksesuar për herë të fundit në korrik 2022:

⁶ Shihni <https://www.healthmedialabirb.com/>.

4. GJETJE

4.1 Profili i të rinjve të anketuar në Shkodër

Nga 350 e rinjtë të anketuar në Shkodër, 65 për qind ishin femra dhe 35 për qind ishin meshkujt (Figura 1), ndërsa raporti ishte thujtë 1:1 në të katërta qarqet. Shumica e të rinjve të anketuar në Shkodër (60%) ishin të moshës 18–24 vjeç, 17% ishin 15–17 vjeç dhe 24% ishin 25–29 vjeç (Figura 2).

Figura 1. Të anketuarit sipas seksit






Figura 2. Të anketuarit sipas grupmoshës.



Më shumë se gjysma (57%) e të rinjve të anketuar në Shkodër jetonin në zona urbane, ndërsa pjesa tjetër (43%) jetonin në zona rurale (Figura 3), krahasuar me raportin 1:1 në katër qarqet.

Figura 3. Të anketuarit e anketës sipas vendbanimit




4.2 Njohuritë rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore

Të dhënat e anketës tregojnë se **shumica e të rinjve në Shkodër e dinë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në vende të huaja** (Figura 4). Megjithatë, **të rinjtë kanë më shumë njohuri se trafikimi ndodh brenda Shqipërisë dhe edhe më pak prej tyre dinë që ndodh në komunitetin ose zonën e tyre**. Pesëdhjetë e tre për qind e të rinjve të anketuar në Shkodër mendojnë se trafikimi i shtetasve shqiptarë në vende të huaja ndodh në masë të madhe ose shumë të madhe, ndërsa 41% mendojnë se ndodh në Shqipëri në masë të madhe ose shumë të madhe. **Vetëm tetë për qind mendojnë se ky fenomen ndodh në komunitetin apo zonën e tyre në masë të madhe apo shumë të madhe.**


Figura 4. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë



Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, në ç' masë ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (shtetasve shqiptarë) në vende të huaja, në Shqipëri dhe në komunitetin ose zonën tuaj? **Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”.** **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Te të rinjtë në Shkodër, femrat kanë më shumë njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 5).


Figura 5. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas seksit



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Rezultatet sipas grupmoshës (Figura 6) tregojnë se të rinjtë e moshës 25 - 29 vjeç kanë më pak njohuri sesa të rinjtë e tjerë se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore, qoftë jashtë ose brenda edhe Shqipërisë, ose në komunitetin apo zonën ku jetojnë.


Figura 6. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Të rinjtë në zonat urbane kanë më shumë njohuri rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë në zonat rurale (Figura 7), me 15 për qind të cilët mendojnë se ndodh shpesh në komunitetin ku jetojnë, krahasuar me zonat rurale, ku të rinjtë mendonin se nuk ndodhte në komunitetin e tyre.

Figura 7. Njohuri për ndodhshmërinë e trafikimit të shtetasve shqiptarë, sipas vendbanimit



Grafiku paraqet vetëm përqindjet për alternativat e përgjigjeve “në masë shumë të madhe” dhe “në masë të madhe”. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Format e shfrytëzimit të shqiptarëve në Shqipëri dhe jashtë vendit

Të rinjtë e anketuar në Shkodër kanë më pak njohuri krahasuar me popullatën e anketuar në katër qarqet e vendit në lidhje me format e shfrytëzimit në Shqipëri dhe jashtë vendit (Tabela 2). Kjo theksohet më tepër në lidhje me njohuritë rreth martesave të detyruara brenda dhe jashtë vendit, lypjes së detyruar të të rriturve brenda dhe jashtë vendit, lypjes së detyruar të fëmijëve brenda dhe jashtë vendit, si dhe kriminalitetit të detyruar të fëmijëve brenda dhe jashtë vendit.

Tabela 2. Njohuritë për format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit (%)

Forma e shfrytëzimit	Në Shqipëri		Jashtë vendit	
	Total, Shkodër	Totali, 4 qarqe	Total, Shkodër	Totali, 4 qarqe
shfrytëzimi seksual i të rriturve	82	80	73	76
shfrytëzimi seksual i fëmijëve	94	87	74	73
puna e detyruar e të rriturve	76	70	70	67
puna e detyruar e fëmijëve	82	83	70	70
martesa e detyruar	65	67	48	56
martesa e hershme	87	85	48	57
lypja e detyruar e të rriturve	59	66	50	56
lypja e detyruar e fëmijëve	92	93	69	76
kriminaliteti i detyruar i të rriturve	81	81	80	81
kriminaliteti i detyruar i fëmijëve	80	83	68	76
N.	350	1,387	350	1,387

Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, format e mëposhtme të shfrytëzimit, që përfshijnë shtetasit shqiptarë, ndodhin brenda apo jashtë Shqipërisë? Tabela tregon përqindjet vetëm për alternativën e përgjigjes "po". **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Grupet në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore

Rezultatet e anketës tregojnë se ka një perceptim të anshëm gjinor të të rinjtë e Shkodrës lidhur me grupet e personave në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore (Tabela 3). Grupi që konsiderojnë më në risk janë vajzat nën moshën 18 vjeç, me 76% që e konsiderojnë këtë grup në risk të madh ose shumë të madh për t'u trafikuar, krahasuar me 77% të popullatës në tërësi. Grupi i dytë më në rrezik trafikimi konsiderohen gratë 18 vjeç e sipër dhe pakicat kombëtare. **Vetëm dy përqind e të rinjve të anketuar në Shkodër mendojnë se burrat janë në rrezik më të lartë trafikimi, krahasuar me pesë për qind të të gjithë popullatës së anketuar, dhe vetëm 18 për qind që mendojnë se djemtë janë në rrezik më të lartë trafikimi, krahasuar me 26 për qind të popullatës së gjerë.**


Tabela 3. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar (%)

Grupi i popullatës	Total, Shkodër	Totali, 4 qarqe
gra (18 dhe mbi 18 vjeç)	38	37
vajza (nën 18 vjeç)	76	77
burra (18 dhe mbi 18 vjeç)	2	5
djem (nën 18 vjeç)	18	26
pakica kombëtare	38	47
persona nga zona rurale	28	30
N.	350	1,387

Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, në ç'masë mendoni se secili nga grupet e mëposhtme janë në risk të konsiderueshëm ose të lartë për t'u trafikuar? Tabela tregon përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Në Shkodër, të rejtat kishin më shumë njohuri sesa të rinjtë lidhur me grupet më në rrezik trafikimi të qenieve njerëzore (Figura 8). Për shembull, 24 për qind e femrave mendojnë se djemtë janë në rrezik më të madh, krahasuar me vetëm trembëdhjetë për qind të meshkujve, ndërsa 50 për qind e femrave kanë njohuri se pakicat kombëtare janë në rrezik të madh, krahasuar me vetëm 27 për qind e meshkujve.


Figura 8. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Ndër të rinjtë në Shkodër, 18 - 24-vjeçarët kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë e tjerë në lidhje me grupet në rrezik më të lartë trafikimi të qenieve njerëzore në Shqipëri (Figura 9). Për shembull, 22 për qind e kësaj grupmoshe e dinë se djemtë janë një rrezik të lartë trafikimi, krahasuar me 14 për qind të 15 - 17-vjeçarëve dhe 25 - 29-vjeçarëve.


Figura 9. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Në Shkodër, krahasuar me të rinjtë në zonat rurale, shumica e të rinjve në zonat urbane kishin njohuri rreth personave në rrezik trafikimi të qenieve njerëzore (Figura 10). Për shembull, 53 për qind e të rinjve në zona urbane e njohin më shumë faktin se pakicat kombëtare janë në rrezik, krahasuar me vetëm 23 për qind të të rinjve në zona rurale.

Figura 10. Njohuri për grupet e popullsisë në risk për t'u trafikuar, sipas vendbanimit.



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës lidhur me opinionin se grupe specifike janë në risk "të konsiderueshëm" ose "të lartë" për t'u trafikuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore

Me qëllim vlerësimin e njohurive të të rinjve të anketuar në Shkodër sa u përket metodave të rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore, të rinjtë u pyetën nëse ishin dakord me disa pohime lidhur me metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore. Rezultatet (Tabela 4) tregojnë se të rinjtë në Shkodër i kanë këto njohuri, ndonëse fenomeni më pak i njohur (58%) është **se familjarët mund të jenë trafikantë. Kjo është shifër më e lartë sesa për popullatën e gjerë**, nga të cilat 48 për qind mendojnë se familjarët mund të jenë trafikantë.


Tabela 4. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore (%)

Metoda e rekrutimit	Total, Shkodër	Totali, 4 qarqe
Trafikantët janë pjesë e rrjeteve të organizuara kriminale	91	90
Për të rekrutuar viktime mund të përdoret interneti	92	94
Trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë shokët	82	86
Trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë anëtarët e familjes	58	48
Trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë të dashurit ose të dashurat	81	85
N.	350	1,387

Pyetje ankete: Në ç'masë jeni dakord ose jo me pohimet e mëposhtme? Tabela raporton përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Ndër të rinjtë e Shkodrës, nuk ka dallim domethënës midis femrave dhe meshkujve (Figura 11), por femrat janë më pak në dijeni **sesa meshkujt rreth faktit që familjarët mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore (54% dhe 61% përkatësisht).**


Figura 11. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Në përgjithësi, **25 - 29-vjeçarët në Shkodër janë pak më në dijeni të faktit se kush mund të jetë trafikant krahasuar me të rinjtë e tjerë** (Figura 12). 64 për qind e dinë se familjarët mund të jenë trafikantë, krahasuar me 56 për qind të të rinjve të grupmoshës 18 - 24 vjeç dhe 51 për qind të të rinjve të grupmoshës 15 - 17 vjeç.


Figura 12. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Në Shkodër, të rinjtë që jetojnë në zona rurale kanë më shumë njohuri sesa ata që jetojnë në zona urbane rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore (Figura 13). Për shembull, 71 për qind dhe 45 për qind, përkatësisht, mendojnë se familjarët mund të jenë trafikantë.

Figura 13. Njohuri rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, sipas vendbanimit




Grafiku paraqet përqindjet e plotësuesve të anketës që janë plotësisht dakord ose disi dakord me pohimet. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Mënyrat për të mbështetur rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore

Në përgjithësi, të rinjtë në Shkodër kanë më shumë njohuri se popullata në katër qarqe për mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 14). Vetëm 76 për qind e të rinjve në Shkodër e dinë që mund t'i raportojnë rastet pranë komisariateve të policisë, krahasuar me 85 për qind të popullatës së gjerë, dhe **shumë më pak (53%) e dinë se mund të raportojnë në linjën telefonike të policisë, 129, krahasuar me popullatën e gjerë (75%), ndonëse pak më shumë e dinë që mund të informojnë organizatat jofitimprurëse.**

Figura 14. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, cili nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Në Shkodër, të rejtat dinë më shumë se të rinjtë rreth mënyrave për të raportuar raste të dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore (Tabela 5). Ndërkohë, **të rinjtë e grupmoshës 25 - 29 vjeç kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë e tjerë se mund t'i raportojnë rastet pranë komisariateve të policisë, ndonjëherë të rinjtë e grupmoshës 18 - 24 vjeç kanë më shumë njohuri se rastet mund t'i raportojnë në linjën telefonike të policisë, 129.**

Të rinjtë e anketuar në zonat rurale të Shkodrës kanë më pak njohuri sesa ata në zonat urbane rreth mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore. Vetëm 20 për qind të të parëve e dinë se rastet e dyshuara mund t'i raportojnë pranë mësuesve ose profesionistëve të tjerë në shkollë, krahasuar me 47 për qind të të dytëve, dhe vetëm 29 për qind e të rinjve në zonat rurale e dinë se mund t'i raportojnë rastet në linjën telefonike të policisë, 129, krahasuar me 76 për qind të të rinjve në zonat urbane. Aplikacioni celular "Telefono, raporto!" nuk njihet aspak nga të rinjtë e anketuar në zonat rurale, krahasuar me nëntë për qind në zonat urbane.


Tabela 5. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit, grupmoshës dhe vendbanimit (%)

Ku të raportoni raste trafikimi	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Vendbanimi	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
komisariat policie	78	74	71	75	82	75	77
linja telefonike e policisë 129	62	45	47	58	47	76	29
mësues, psikolog, profesionist tjetër në shkollë	46	22	31	36	30	47	20
punonjës i mbrojtjes së fëmijës	25	13	16	20	19	24	14
organizatë jofitimprurëse	31	25	25	29	27	35	20
mjek ose infermier	25	16	24	20	20	28	13
linja kombëtare për këshillimin e fëmijëve ALO 116	19	9	13	15	12	23	4
linja telefonike kombëtare (116 006)	8	7	9	6	9	10	5
aplikacion telefonik ("Telefono, Raporto!")	6	4	5	3	8	9	0
profesionist tjetër në bashki/njësinë administrative përkatëse	10	7	5	6	16	14	3
asnjëra nga alternativat e mësipërme	4	8	7	7	3	1	11
N.	226	124	58	209	83	200	150

Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, cili nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Vetëm 38 për qind e të rinjve në Shkodër njohin të paktën tri mënyra për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 15), krahasuar me 49 për qind në popullatën e përgjithshme të anketuar në katër qarqet.

Figura 15. Njohuri për të paktën tri mënyra për të raportuar rastet e dyshuara për trafikim qeniesh njerëzore



Popullata e synuar: Shkodër; Total, 4 qarqe.

Raportimi ballë për ballë me oficerët ligjzbatues është mënyra e parapëlqyer e raportimit për të gjithë të rinjtë (**76% për të rinjtë në Shkodër dhe 72% për të rinjtë në popullatën e gjerë; Tabela 6**).

Tabela 6. Kanalet e parapëlqyera të raportimit të një rasti të dyshuar për trafikim qeniesh njerëzore (%)


Mënyrat e raportimit të rastit të trafikimit	Total, Shkodër	Totali, 4 qarqe
ballë për ballë tek institucionet ligjzbatuese (polici, prokurori)	76	72
shërbimet telefonike (linjat e këshillimit, linjat e ndihmës)	37	36
raportimi ballë për ballë tek institucionet joligjzbatuese	29	24
OJF e specializuar për çështjen	20	12
platformë në internet, aplikacion telefoni	11	9
asnjëra nga alternativat e mësipërme	5	4
nuk e di	1	1
N.	350	1,387

Pyetje ankete: Cilin nga kanalet e mëposhtme do të konsideroni ose do të parapëlqenit për raportimin e një rasti trafikimi qeniesh njerëzore? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë në Shkodër kanë njohuri rreth shërbimeve mbështetëse në dispozicion të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, dhe shumë prej tyre i njihnin shumicën e këtyre shërbimeve krahasuar me popullatën e gjerë (Figura 16).

Figura 16. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri



Pyetje ankete: Në dijeninë tuaj, cilat nga llojet e mëposhtme të mbështetjes janë të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Ndër të rinjtë e Shkodrës, **femrat kanë më shumë dijeni se meshkujt rreth llojeve të mbështetjes së disponueshme në Shqipëri për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore** (Tabela 7). Në veçanti, femrat (33%) e dinë më shumë se meshkujt (22%) se ka shërbim psiko-social të disponueshëm. **Më shumë të rinj të grupmoshës 25 - 29 vjeç (40%) e dinë se mbështetja psikosociale është e disponueshme për viktimat krahasuar me grupmoshat e tjera** (19% e 15 - 17-vjeçarëve, dhe 24% e 18 - 24-vjeçarëve). **Ndërkohë, të rinjtë në zonat urbane në Shkodër kanë më shumë njohuri sesa të rinjtë në zonat rurale rreth shumicës së shërbimeve mbështetëse në dispozicion të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.**


Tabela 7. Njohuri rreth mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit, grupmoshës dhe vendbanimit (%)

Lloji i mbështetjes për viktimat	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Vendbanimi	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
mbështetje e posaçme nga policia e shtetit	45	40	43	44	40	50	35
mbështetje psiko-sociale (shëndeti mendor)	33	22	19	24	40	34	20
mbështetje financiare	22	21	19	23	20	25	17
mbështetje sociale (përfshirë mbështetjen për riintegrim) nga qeveria	26	27	28	26	26	23	29
mbështetje sociale (përfshirë mbështetjen për riintegrim) nga OJF-të	18	12	15	18	10	18	12
këshillim, mbështetje nëpërmjet linjave telefonike të këshillimit ose ndihmës	19	8	13	17	7	21	6
akomodim në strehë	18	8	14	13	11	21	4
mbështetje mjekësore	25	15	18	21	19	30	9
mbështetje për strehim	17	8	10	15	9	17	7
mbështetje për punësim	19	8	8	14	16	20	6
këshillim për të drejtat ligjore dhe shërbimet e disponueshme	14	7	11	8	17	16	5
mbështetje e posaçme për trajnim ose arsimim	7	4	1	8	3	8	3
nuk e dinte ose nuk u përgjigj	18	28	31	19	27	13	34
N.	226	124	58	209	83	200	150

Popullata e synuar: Shkodër.

Vetëm 37 për qind e të rinjve të anketuar në Shkodër ishin në dijeni për të paktën tri lloje mbështetjeje për viktimat e trafikimit (Figura 17), krahasuar me 39 për qind të popullatës së përgjithshme të anketuar në të katërta qarqet.

Figura 17. Njohuri rreth të paktën tri formave të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri




Popullata e synuar: Shkodër; Total, 4 qarqe.

4.3 Qëndrimet lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Niveli i shqetësimit

Të rinjtë e Shkodrës janë më pak të shqetësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me popullatën e gjerë (60% dhe 69% përkatësisht; Figura 18).


Figura 18. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri



Pyetje ankete: Sa i/e shqetësuar jeni për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri? Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Te të rinjtë në Shkodër, meshkujt janë më pak të shqetësuar sesa femrat në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri (42% dhe 80%, përkatësisht janë shumë të shqetësuar; Figura 19).


Figura 19. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Të rinjtë e moshës 18-24 vjeç në Shkodër janë më të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore sesa grupmoshat e tjera (69% jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar, krahasuar me 59% të grupmoshës 15-17 vjeç dhe 43% të grupmoshës 25-29 vjeç; Figura 20).


Figura 20. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Në Figurën 21 tregohet se në Shkodër, më shumë të rinj në zonat urbane (83%) janë shumë të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore krahasuar me të rinjtë në zona rurale (36%).

Figura 21. Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas vendbanimit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që ndihen 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' të shqetësuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Të rinjtë në Shkodër raportuan se ishin më të shqetësuar për moszbatimin e ligjit, rritjen e trafikimit të të rinjve dhe fëmijëve, dhe nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të popullatës rreth fenomenit (Tabela 8).

Të rejtat në Shkodër janë më të shqetësuar sesa të rinjtë rreth moszbatimit të ligjit (66% krahasuar me 57%), ndonëse, nga ana tjetër, të rinjtë janë më të shqetësuar sesa të rejtat rreth lidhjes midis migrimit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore (24% krahasuar me 14%).

Rezultatet sugjerojnë se të rinjtë në zonat rurale janë më të shqetësuar sesa të rinjtë në zonat urbane rreth mbështetjes së pamjaftueshme për viktimat e trafikimit (49% dhe 23% përkatësisht). Të rinjtë në zonat rurale (31%) janë më të shqetësuar sesa të rinjtë në zonat urbane (10%) për lidhjen midis migrimit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore konsiderohet një shqetësim madhor nga më shumë se gjysma e të rinjve të anketuar në zonat rurale (54%), krahasuar me vetëm 29% të të rinjve në zonat urbane.

Tabela 8. Fushat më kryesore të shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, sipas seksit, grupmoshës dhe vendbanimit (%)


Fusha e shqetësimit	Totali		Shkodër						
	Shkodër	4 qarqe	Seksi		Grupmosha (vjeç)			Vendbanimi	
			F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
mungesa e zbatimit të ligjit	62	72	66	57	55	64	60	70	50
rritja e trafikimit të fëmijëve dhe të rinjve	44	63	44	43	53	45	36	46	42
niveli i ulët i ndërgjegjësimit të popullatës lidhur me këtë fenomen	40	47	37	43	33	36	53	29	54
besueshmëria e ulët të institucionet përkatëse ku raportohen raste të tilla	28	41	33	20	15	29	30	24	33
mbështetja e pamjaftueshme për viktimat	34	34	33	36	23	30	51	23	49
lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore	25	28	23	29	19	22	38	14	41
rritja e trafikimit të të rriturve	24	28	24	26	24	27	19	23	27
lidhja ndërmjet migracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore	19	17	14	24	5	15	35	10	31
N.	350	1,387	226	124	58	209	83	200	150

Pyetje ankete: Çfarë ju shqetëson më shumë? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Qëndrimet nga viktimave

Të rinjtë në Shkodër kanë besim të fortë se viktimat e trafikimit duhet të mbështeten, megjithëse më pak se popullata e gjerë (79% dhe 90% përkatësisht; Figura 22).

Figura 22. Niveli i dakordësimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar



Pyetje ankete: Sa dakord jeni me ofrimin e mbështetjes së posaçme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ose personat në risk për t'u trafikuar? Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë 'jashtëzakonisht' ose 'shumë' dakord. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Të rejtat në Shkodër kanë më shumë empati drejt viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me të rinjtë (93% dhe 65% përkatësisht; Tabela 9). Të rinjtë e grupmoshës 15 - 17 vjeç kanë më pak empati drejt viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me të rinjtë e tjerë. Vetëm 69 për qind e 15 - 17-vjeçarëve besojnë se viktimat duhet të mbështeten, krahasuar me 85 për qind të 18 - 24-vjeçarëve. Ndërkohë, ka pak empati ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në zonat rurale të Shkodrës. Vetëm 64 për qind e të rinjve në zona rurale besojnë se viktimat duhet të mbështeten, krahasuar me 92 për qind të të rinjve në zonat urbane.

Tabela 9. Niveli i dakordësimit me ofrimin e mbështetjes për viktimat e trafikimit dhe personat në risk për t'u trafikuar, sipas seksit, grupmoshës dhe vendbanimit (%)

Niveli i dakordësimit	Gjinia		Grupmosha (vjeç)			Vendbanimi	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
jashtëzakonisht ose shumë	93	65	69	85	71	92	64
disi	7	23	14	13	21	7	24
pak ose aspak	0	6	2	2	3	0	7
nd ose np	0	6	0	0	5	1	5
N.	226	124	58	209	83	200	150


Popullata e synuar: Shkodër. nd - nuk e di; np - nuk u përgjigj.

4.4 Praktikrat lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë e anketuar në Shkodër kanë pak interes të mësojnë për trafikimin e qenieve njerëzore (Figura 23) sesa popullata në tërësi e anketuar në katër qarqet. Vetëm 25 për qind e të rinjve të anketuar në Shkodër janë shumë të interesuar që të mësojnë rreth mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 39 për qind të popullatës së gjerë, dhe vetëm 24 për qind të të parëve janë shumë të interesuar që të mësojnë se ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të përfituar mbështetje, krahasuar me 43 për qind të të dytëve. Të rinjtë e anketuar në Shkodër janë më të interesuar që të mësojnë se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore ose rreth profilit të trafikantëve të qenieve njerëzore.


Figura 23. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Deri në cilën masë jeni i/e interesuar për të mësuar rreth këtyre aktiviteteve? Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Të rejtat në Shkodër janë më të interesuara sesa të rinjtë për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore (Figura 24). Për shembull, 43 për qind e femrave ishin të interesuara që të mësonin më shumë rreth trafikantëve të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 15 për qind të meshkujve.

Figura 24. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Më të rinjtë (15-24 vjeç) janë më të interesuar të mësojnë rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të më të mëdhenjtë (25-29 vjeç) (Tabela 10).


Tabela .10. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

Çështje të trafikimit të qenieve njerëzore	Grupmosha (vjeç)		
	15-17	18-24	25-29
Kush është në risk për t'u trafikuar	20	25	12
Format e ndryshme të shfrytëzimit	11	19	6
Profili i trafikantëve ose kush mund të jetë trafikant	29	32	21
Metodat ose taktikat e rekrutimit të viktimave	18	27	20
Mënyrat për të mbështetur rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore	26	29	17
Ku mund të drejtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë ose mbështetje	30	26	18
N.	58	209	83

Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Të rinjtë e anketuar në zonat urbane të Shkodrës janë më të interesuar të mësojnë rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sesa të rinjtë në zonat rurale (Figura 25). Për shembull, 39% e personave në zona urbane kanë interes të mësojnë se kush mund të jetë trafikant ose rreth profilit të trafikantit, krahasuar me 18 për qind të të rinjve në zona rurale.

Figura 25. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas vendbanimit



Grafiku paraqet përqindjen e plotësuesve të anketës që janë shumë të interesuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Interesi për t'u përfshirë në parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore

Të rinjtë në Shkodër janë më pak të interesuar për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata në tërësi (Tabela 11). Ata janë më pak të interesuar të mbledhin fonde për programe kundër trafikimit (39%) ose të punojnë vullnetarisht në një OJF kundër trafikimit (38%).


Tabela .11. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore (%)

Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore	Total, Shkodër	Totali, 4 qarqe
Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit	51	59
Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet	48	55
Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	48	61
Vullnetarizmi në aktivitetet kundër trafikimit të një OJF-je	39	39
Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit	38	40
Raportimi diku për një viktimë të mundshme trafikimi qeniesh njerëzore	47	59
Raportimi për një të dyshuar si trafikant qeniesh njerëzore	49	57
N.	350	1,387

Pyetje ankete: Sa i/e interesuar do të ishit të përfshiheshit në aktivitetet e mëposhtme? Grafiku raporton përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. **Popullata e synuar:** Shkodër; Total, 4 qarqe.

Të rejtat e anketuara në Shkodër janë shumë më të interesuara të përfshihen në aktivitetet kundër trafikimit të qenieve njerëzore se sa të rinjtë (Figura 26). Në të gjitha kategoritë e anketës në fjalë, 57 - 72 për qind e femrave raportuan se janë të interesuara që të përfshihen në këto aktivitete, krahasuar me vetëm 19 - 31 për qind të meshkujve.

Figura 26. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar:** Shkodër.

Më të rinjtë e anketuar (18-24 vjeç) janë më të interesuar të angazhohen në aktivitetet e lidhura me parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave (Table 12) sesa më të mëdhenjtë (25 - 29 vjeç).


Tabela .12. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas grupmoshës (%)

Aktiviteti i parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore	Grupmosha (vjeç)		
	15-17	18-24	25-29
Ofrimi i ndihmës ose mbështetjes për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit	53	59	33
Përfshirja në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet	46	55	33
Informimi i familjarëve ose miqve për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	42	57	33
Vullnetarizmi në aktivitetet kundër trafikimit të një OJF-je	39	49	18
Mbështetja e mbledhjes së fondeve për programet kundër trafikimit	38	46	21
Raportimi diku për një viktimë të mundshme trafikimi qeniesh njerëzore	43	56	30
Raportimi për një të dyshuar si trafikant qeniesh njerëzore	47	56	33
N.	58	209	83

Grafiku raporton përqindjen e plotësuesve të anketës që janë 'shumë' ose 'disi' të interesuar. Popullata e synuar: Shkodër.

Të rinjtë e zonave urbane të anketuar në Shkodër janë shumë më të interesuar të përfshihen në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë në zonat rurale (Figura 27). Në të gjitha kategoritë e anketës në fjalë, 64 - 73 për qind e të rinjve në zona urbane raportuan se janë të interesuar që të përfshihen në këto aktivitete, krahasuar me vetëm 11 - 29 për qind të të rinjve në zona rurale.

Figura 27. Niveli i interesit për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas vendbanimit




Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë ose disi të interesuar. **Popullata e synuar: Shkodër.**

4.5 Rezultatet e strategjisë së komunikimit të UNICEF-it

Vetëm dymbëdhjetë për qind e të rinjve të anketuar në Shkodër raportuan se janë ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit (Figura 28).⁷ Nga këta të rinj, 56% ishin ekspozuar ndaj materialeve nëpërmjet televizionit, 49% nëpërmjet bisedave në shkollë, 33% nëpërmjet Facebook-ut (Meta), 32% nëpërmjet Instagram-it, 14% nëpërmjet broshurave ose materialeve të shtypura, dhe 3% nëpërmjet Tik Tok-ut.

⁷Kjo i referohet punës së ndërmarrë nga UNICEF Shqipëri dhe partnerët e tij në kuadrin e Programit Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria, nga prilli i vitit 2020 deri në momentin e intervistave të anketës.


Figura 28. Kanalet e ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit për trafikimin e qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Nëpërmjet cilit kanal të mëposhtëm komunikimi u informuat për ngjarjet, mesazhet ose materialet e komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore? Zgjedhje të shumëfishta. **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Shkodër.

Ndonëse disa nga të rinjtë e anketuar në Shkodër raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve për trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit, **ata gjithashtu raportuan se njohuritë e tyre për këtë çështje ishin shtuar si rezultat i ekspozimit** (5% në masë shumë të madhe, 44% në masë të madhe, dhe 47% në një farë mase; Figura 29).


Figura 29. Masa e përmirësimit të njohurive për trafikimin e qenieve njerëzore pas ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit



Pyetje ankete: Deri në ç'masë është përmirësuar niveli njohurive tuaja rreth trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Shkodër.

Krahas kësaj, 81 për qind e të rinjve të ekspozuar ndaj këtyre materialeve deklaruan se qëndrimet e tyre ndaj trafikimit të qenieve njerëzore kanë ndryshuar (Figura 30), dhe se tani janë të interesuar të luajnë një rol më aktiv në luftën kundër këtij fenomeni (14% në nivel shumë të lartë, 34% në nivel të lartë dhe 33% disi të interesuar).

Figura 30. Masa e ndryshimit të qëndrimeve pas ekspozimit ndaj materialeve rreth trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetje ankete: Deri në ç'masë ka ndryshuar qëndrimi juaj lidhur me përfshirjen më aktive në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit? **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar, që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore; Shkodër.

5. PËRFUNDIME

Ky raport paraqet gjetjet kryesore nga anketa e valës së dytë dhe mundëson pikëpamje të vlefshme rreth njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve në Shkodër sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore. Këto gjetje do t'u vlejnjë subjekteve anti-trafikim që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të mbrojtjes së viktimave.

Për sa i përket nivelit të njohurive, të dhënat e anketës tregojnë se pjesa më e madhe e të rinjve në Shkodër e dinë se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në vende të huaja, edhe pse ka më pak që dinë se trafikimi ndodh dhe brenda Shqipërisë dhe shumë më pak e dinë se ndodh në komunitetin apo zonën e tyre. Te të rinjtë e anketuar, ka më shumë femra sesa meshkuj që e dinë se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore dhe kjo njohuri është më e madhe te të rinjtë e anketuar në moshë më të vogël dhe tek ata që jetojnë në zona urbane.

Të rinjtë në Shkodër kanë më pak njohuri sesa popullsia e gjerë rreth formave të shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe jashtë vendit, veçanërisht për sa u përket martesave të detyruara, lypjes së detyruar nga të rriturit dhe fëmijët, si dhe kriminalitetit të detyruar të fëmijëve. Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar në Shkodër kanë pak njohuri se grupe të tjera përveç grave dhe vajzave (nën 18 vjeç) mund të jenë viktimat trafikimi, ndonëse femrat, ndonëse femrat, 18-24 vjeçarët dhe personat që jetojnë në

zona urbane dinë më shumë sesa të rinjtë e tjerë të anketuar, për sa i përket riskut për t'u trafikuar. Të rinjtë në Shkodër kanë njohuri rreth metodave të rekrutimit për trafikim të qenieve njerëzore, dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore. Megjithatë, pak e dinin se trafikantë të qenieve njerëzore mund të jenë edhe familjarët. Femrat, 25-29 vjeçarët dhe të rinjtë në zonat rurale kanë më shumë njohuri rreth metodave të rekrutimit të qenieve njerëzore.

Krahasuar me popullatën totale të anketuar në katër qarqet, të rinjtë në Shkodër kanë pak njohuri rreth disa mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht të linjës telefonike të policisë, 129. Më shumë të reja, 25-29 vjeçarë, dhe të rinj në zona urbane dinin më shumë mënyra të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me të rinjtë e tjerë. Të rinjtë në Shkodër kanë pak njohuri rreth shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Mbi një e treta e të rinjve të anketuar në Shkodër nuk i njohin llojet e mbështetjes për viktimat e trafikimit në Shqipëri, ndërsa këto njohuri janë më të larta te femrat dhe të rinjtë në zona urbane.

Krahasuar me popullatën e përgjithshme të anketuar në katër qarqet, të rinjtë në Shkodër ishin më pak të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore. Ky shqetësim është më i madh te femrat, 18-24 vjeçarëve, dhe të rinjtë në zona urbane.

Qëndrimet e të rinjve në Shkodër kundrejt viktimave janë pozitive, me 79% që raportojnë se viktimave duhet t'u sigurohet mbështetje. Femrat, 18-24 vjeçarët, dhe të rinjtë në zona urbane i mbështetin më tepër viktimat e trafikimit sesa grupet e tjera të të rinjve.

Në praktikë, të rinjtë në Shkodër janë më pak të interesuar sesa popullata në tërësi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore. Ata janë më të interesuar që të mësojnë se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore ose rreth profilit të trafikantëve të qenieve njerëzore. Interesi i femrave, grupmoshës 15-24 vjeç dhe të rinjve në zona urbane për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore është më i lartë. Ata janë më pak të interesuar për t'u përfshirë në aktivitete parandalimi dhe mbrojtjeje nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa popullata në tërësi. Femrat, 15-24-vjeçarët dhe të rinjtë në zona urbane janë më të interesuar të përfshihen se të rinjtë në Shkodër.

Pak të rinj në Shkodër (11%) raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të kaluara. Megjithatë, 96 për qind e atyre që raportuan këtë ekspozim, raportuan gjithashtu se njohuritë rreth fenomenit ishin shtuar, dhe ç'është më e rëndësishmja, 81 për qind e të rinjve të ekspozuar raportuan ndryshim qëndrimesh ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe interes të shtuar për të luajtur rol më aktiv në luftimin e këtij fenomeni.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se subjektet e përfshira në luftën kundër trafikimit duhet t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre te përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore te të rinjtë meshkuj e të gjitha grupmoshave, si dhe te të rinjtë në zonat rurale të Shkodrës. Duhet t'i kushtohet vëmendje përmirësimit të njohurive për praninë e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe në Shkodër; faktit se djemtë, burrat, pakicat kombëtare, dhe të rinjtë në zona rurale janë në rrezik trafikimi; se pjesëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore; duke theksuar mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore te subjekte të tjera veç policisë; dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Programet parandaluese mund të synojnë gjithashtu përmirësimin e qëndrimeve të të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, ndërsa programet e ardhshme arsimore mund të përdorin metoda komunikimi të njohura nga të rinjtë e anketuar në Shkodër, përkatësisht televizioni, bisedat në shkollë, mediat sociale dhe materialet e shtypura.

